



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dispozitave Ligjore në fuqi lidhur me KAB-in, sipas Qarkores buxhetore 2021/01, nenit 40 paragrafi 2. nen 2 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 14.06.2021, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më 25.06.2021 mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin

E Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2022-2024 për Komunën e Klinës

I

Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2022-2024 si në vijim:

Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024	Buxheti aktual 2021	Planifikimi 2022	Vlerësimi 2023	Vlerësimi 2024
Granti i përgjithshëm	4,080,410.00	4,145,145.00	4,327,424.00	4,534,191.00
Granti i arsimit	4,489,494.00	4,695,962.00	4,930,760.00	5,177,298.00
Granti i shëndetësisë	1,426,360.00	1,426,360.00	1,497,678.00	1,572,562.00
Të hyrat vetanake	915,074.00	1,065,865.00	1,131,104.00	1,181,465.00
Financimi për shërbimet rezidenciale	-	-	185,000.00	185,000.00
Totali :	10,911,338.00	11,333,332.00	12,071,966.00	12,650,516.00

II

Vendimi si në pikën I miratohet me vërejtje dhe sugjerime që janë pjesë përbërëse e Procesverbalit të këtij Kuvendi të mbajtur me 25.06.2021.

III

Ky vendim hyn në fuqi 7 pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe publikimit në web faqe zyrtare të Komunës komfor Rregullores QRK nr.10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave-Lista I-Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë.

IV

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, MF- Departamenti i Buxhetit të MFT, Kryetari Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtoritë komunale dhe një kopje për Arkivin e Komunës Klinë.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-20729 /2021
Klinë më 29.06 2021



Kryesuesi,
Fadil Gashi